

VENDIM
Nr.731, datë 6.11.2003

PËR PËRCAKTIMIN E NJËSIVE TË SHOQËRISË ANONIME "ALBPETROL", QË NUK DO TË KONSIDEROHEN PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shoqërinë "Albpetrol" sh.a., nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë njësitet, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Njësitet e përcaktuara në pikën 1 t'i nënshtrohen privatizimit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
 3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E NJËSIVE TË "ALBPETROL" SHA, QË NUK DO TË VLERËSOHEN PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

1. Stacionet e pompimit të naftës: Gostimë (Elbasan), Uji i Ftohtë (Vlorë), Skroftinë (Vlorë), Levan (Fier).
2. Stacionet për transportimin e gazit natyror: Kuçovë, Cërrik, Patos, Kavajë, Elbasan.
3. Tubacione transporti naftë (naftës-jellës): Visokë-Fier (pjesë e tij); Kuçovë-Cërrik, VB Kuçovë-UPN Kuçovë.
4. Tubacione transporti nënproduktësh (benzinës-jellës): Kuçovë-Zharrëz; Cërrik-Kuçovë.
5. Rezervuarë naftë: Visokë (2x20m³); Linas-Elbasan (1x250 m³); Kuçovë (1x20 m³).
6. Gazsjellësi Ballaj-Kavajë.
7. Centralët telefonikë të naftës (të qendrës së shërbimit elektrik-telefonik Patos): Fier, Visokë, Ballsh, Drenovë.
8. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Patos: ish-zyrat e sektorit të pestë Patos.
9. Ndërtesa në funksion të aktivitetit me qendrën e prodhimit të gazit Patos: godina e pompistëve të benzinës Ballsh; dhoma pune operatorësh Vlorë; banesë në Linas (Elbasan); godinë pikturë QTNG Patos; ndërtesa në ish-sektorin e gazit Divjakë (4 ish-fjetore dhe mensa me tallash betoni, dy fjetore me tulla, dy ish-banjo, zyrat e sektorit, magazina bashkë me shtesën, ofiçina) ndërtesa e sallës së kompresorit YSC; ndërtesa e qendrës së sektorit të gazit Ballaj; salla e pompave të ujit Povelçë; depo betoni në Finiq (Matomare).
10. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Kuçovë: ish-zyrat e sektorit të parë; tetoja e traktorëve sektori I; salla e riparimit të pompave të thellësisë-Kozare; godina e kompresorit të gazit sektori IV; zyrat e sektorit Arrëz; zyra e djegies nëntokësore në Gegë; tetoja e rërës kuarcore; ish-zyrat e remontit kapital; zyrat e dispeçerisë së parkut; ish-banja-dushe; zyrat e vjetra të ndërmarrjes; ofiçina e riparimit të mjeteve të rënda Kuçovë; magazina rikupero (pranë parkut të naftës Kuçovë).
11. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Marinëz: zyrat e vjetra të ndërmarrjes; ndërtesë magazine; ndërtesa e ish-sektorit të gazit; godina e ish-muzeut Marinës.

12. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Sheqishtë: ish-zyrat e sektorit Kallm Verri.

13. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të naftës Ballsh: kabinë elektrike Hekal 22; ndërtesa e zyrës zona nr.2, Qafa e Vidhit.

14. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në qendrën e prodhimit të rërës bituminoze: ish-zyrat; godina e laboratorit të uzinës së rërës bituminoze; ish-kabina elektrike e ofiçinës; ish-depo e dinamitit Kasnicë.

15. Ndërtesa në funksion të aktivitetit në sektorin e administrimit dhe furnizimit materialo-teknik: depo e acideve Patos; karburanti i vjetër në Kuçovë.